

DPA/DMP

03-1383/13

02

14-05-2013

Shifra:0599,Nr.8111/2013

GJYKATA THEMELORE,DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE –FERIZAJ, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Sahadete Lohaj nga fsh.Budrikë,për shkak të veprës kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik ,dhe deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të neneve 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet,më datën 29.04.2013, muarr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Sahadete Tefik Lohaj nga fsh.Budrikë K Viti,për vepër kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik ,dhe deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, në mungesë të provave se e pandehura ka kryer veprën kundërvajtëse të ngarkuar si në kërkesën e AKK ,konform nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të kësaj gjykate.

Nga një ekzemplarë i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë,bëri kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-2208/2012,të dt.04.06.2012,kundër të pandehurës për shkak të kundërvajtjes nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik ,dhe deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar dhe kërkoi që e njëjta të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

E pandehura me aktvendimin e kësaj gjykate RI.nr.11533/2012 të dt.01.11.2012 , është shpallur fajtores dhe është dënuar me dënim në të holla në shumë prej 1000 € (një mijë euro) dhe është ngarkuar me shpenzime paushalle të procedurës në shumë prej 10 € (dhjetë euro) .

Me dt.10.12.2012 e pandehura ka pranuar aktvendimin në fjalë mbi dënim dhe brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë në të cilin ka theksuar se Gjykata ka nxjerr aktvendim jo të bazuar në ligj .


Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë-Divizioni për kundërvajtje duke vendosur sipas ankesës së të pandehurës ka abroguar aktvendimin e sipërpërmendur të kësaj gjykate dhe lëndën e ka kthyer në plotësim procedure dhe rivendosje dhe në aktvendim të saj KA.nr.172/2013 të dt.06.03.2013 ka udhëzuar këtë Gjykatë që të ndërmerr këto veprime procedurale : të dëgjoj parashtruesin e kërkesës me procesverbal dhe të sqarohen rrethanat për kryerjen e kundërvajtjes si dhe të përcaktohet se për cilin lloj mosdeklarimi të pasurisë ngarkohet e pandehura dhe në cilën kohë –periudhë dyshohet se e njëjta ka kryer kundërvajtje,të ftoj të pandehurën për tu deklaruar se a posedon prova që shkojnë në favor të saj dhe sipas nevojës të nxjerr edhe prova tjera,e pastaj Gjykata të nxjerr aktvendim merititor.

Gjyqtari duke vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së Apelit të Kosovës të dhëna në aktvendimin e saj KA.nr.172/2013 ka marr në pyetje në cilësi të dëshmitarit parashtruesin e kërkesës A.Behrami –shef i Divizionit pranë AKK në Prishtinë dhe ka dëgjuar edhe të pandehurën S.Lohaj,dëshmitari i lartcekur në deklaratën e tij të dhënë pranë kësaj gjykate ka deklaruar se në muajin mars të këtij viti- 2012 ,ka filluar procesi i deklarimit të pasurisë për zyrtarët e lartë publik të cilët edhe më herët kanë bërë deklarimin e pasurisë – deklarim të rregullt vjetor,mirëpo meqenëse ligji për këtë qështje ka ndryshuar nga viti i kaluar ku tani

kanë hyrë edhe një numër tjetër i zyrtarëve të lartë publik të cilët më herët nuk kanë pasur obligim për deklarim të pasurisë, agjencioni ka kërkuar që edhe këta zyrtarë të lartë publik të deklarojnë pasurinë dhe për këta njoftimin e kemi bërë përmes zyrtarëve kontaktues nëpër institucione, ndërsa për komunën e Ferizajt këtë e kemi kërkuar ta bëjë personi ynë kontaktues Naser Musa, i cili dhe na ka informuar se njoftimin e ka bërë në një mbledhje të asamblesë komunale dhe përmes kryesuesit të asamblesë i cili i ka njoftuar për këtë qështje këshilltarët nga foltorja e kuvendit dhe më tej ka shtuar se ne ndonjë kërkesë të veçantë nuk ju kemi drejtuar këshilltarëve të asamblesë së Ferizajt, dhe më fund ka theksuar se ne mbetemi pranë kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse që e kemi bërë ndaj të pandehurës dhe konsiderojmë se e njëjta nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë sipas kërkesë sonë të cilën ia kemi drejtuar asaj përmes zyrtarit kontaktues së komunës së Ferizajt siç është paraparë në nenin 4 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa e pandehura në deklaratën e saj të dhënë pranë kësaj gjykate me dt. 29.04.2013 ka theksuar se unë nuk kam pasur njohuri për atë se kam pasur obligim për deklarim të pasurisë gjer me dt. 31.3.2012, e lëre më të kem pasur ndonjë kërkesë nga AKK për deklarimin e pasurisë pranë tyre se po të kisha qenë e njoftuar apo të kisha pasur ndonjë kërkesë do ta kisha bërë këtë deklarim të pasurisë pa kurrfar problemi siq e kam bërë me vonesë kur kam mësuar për këtë qështje siq shifet nga vërtetimi i AKK i dt. 27.09.2012, dhe ka shtuar se në atë kohë kur paska qenë dashur të bëhet deklarimi i pasurisë unë i kam pasur edhe disa probleme shëndetësore.

Gjyqtari duke u bazuar në kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse që të pandehurën e ngarkon për veprën kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenet 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, të cilët nene bëjnë fjalë për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës së AKK, deklaratën e të pandehurës e cila nuk e pranon veprën që i ngarkohet në kërkesë duke theksuar se nuk ka qenë e informuar dhe as që ka pranuar formularin për deklarimin e pasurisë nga askush, në deklaratat e dy zyrtarëve komunal të Ferizajt të cilët kanë deklaruar se i kanë njoftuar këshilltarët komunal, por nuk kanë vërtetuar me asgjë se e pandehura është njoftuar dhe që ka pranuar formularin për deklarim të pasurisë, e veqanërisht duke analizuar deklaratën e shefit të divizionit të AKK, i cili thekson se ne kemi bërë kërkesa për fillim të procedurës kundërvajtëse në gjykatë për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës së AKK dhe këtë e kemi bërë edhe ndaj të pandehurës në fjalë dhe ne edhe tani mbetemi pranë kësaj kërkesë dhe duke e analizuar në këtë rast secilën provë veq e veq dhe ato në tërësi konstatoi se nuk ka prova se e pandehura ka kryer veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në kërkesë-për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës së AKK, ngase e njëjta në këtë rast nuk ka pasur kurrfar kërkesë që i është drejtuar nga AKK për deklarim të pasurisë së saj dhe se kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse nuk përmban përshkrimin faktik të veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes dhe bazuar në krejt nënvlerësitë që ka më lartë, në mënyrë të nenit 198 al. 1 pika 8 të LK-së, gjyqtari vendos për shpallje të dështimit të këtij aktvendimi.

Sekretarja juridike
Kimete Bytyqi



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit, Departamentin e përgjithshëm-Divizionin për kundërvajtje në Prishtinë, mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe e pandehura në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, nëpërmes të kësaj Gjykate, pa pagesë takse.